



Bazuar në nenin 8 të Ligjit nr.03/L-212 Ligji i Punës të Republikës së Kosovës, nenin 4 të Udhëzimit Administrativ nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, si dhe në bazë të Marrëveshjes së veçantë për grand për projektin: “Climate Appropriate Urban Development Wastewater Prishtina”, me nr. të Protokollit 3369, të datës 09.12.2022, të nënshkruar në mes të Ministrisë së Ekonomisë, KfW-së dhe KRU “Prishtina” Sh.A., Prishtinë, publikon këtë:

## K O N K U R S

### Për plotësimin e vendeve të lira

1. Gjashtë (6) pozita – Inxhinier të Hidroteknikës
2. Dy (2) pozita – Inxhinier të Gjeodezisë
3. Dy (2) pozita – Inxhinier të mjedisit, mbrojtje dhe siguri në punë

Inxhinieret e interesuar do të përfitojnë përmes një programi të trajnimit intensiv me ekspert vendor dhe ndërkombëtar dhe do të ekspozohen në një nder projektet e infrastrukturës me të madhe në Kosovë deri me tani dhe do të kenë mundësinë të zhvillohen në pozita menaxheriale në të ardhmen. Inkurajojmë profesionistët e ri të aplikojnë për këto pozita.

#### **Inxhinier të Hidroteknikës**

**Përgatitja arsimore/profesionale: Diplomë Masteri Teknik / Hidroteknikë**

**Përvoja e punës: minimum 2 vite**

**Numri i kryeseve: 6**

**Njohja e gjuhës Angleze: Mirë (në të folur dhe në shkrim)**

**Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:**

- Punon në kalkulimin e çmimeve për paramasë dhe paralogarit dhe përgatit apo kompletion dokumentet për projektet e ujësjellësit (kompletimin e tender dokumentit).
- Bashkëpunon dhe me shërbimet tjera në KRU Prishtina.
- Pas koordinimit të punëve në zyrë të planifikimit dhe punimit të projekteve sipas kërkesës së shërbimeve obligohet të përcillen zhvillimet e punimeve edhe në teren.
- Përgatit tërë dokumentacionin teknik për kryerjen e punëve dhe të njëjtin i dërgon shefit të shërbimit të projektimit.
- Bashkëpunon dhe koordinon punën me stafin inxhinierik në hartimin e projekteve investive në fushën e Hidroteknikës.
- Bënë mbikëqyrjen e implementimit të projekteve.
- Pranon punë dhe përgjegjësi të tjera nga udhëheqësit konform nevojave të kompanisë.
- Kryen punë tjera dhe i raporton Shefit të Shërbimit dhe Menaxherit të Departamentit.

### **Inxhinier të Gjeodezisë**

**Përgatitja arsimore/profesionale: Diplomë Masteri Teknik, drejtimi Gjeodezisë**

**Përvoja e punës: minimum 2 vite**

**Numri i kryeseve: 2**

**Njohja e gjuhës Angleze: Mirë (në të folur dhe në shkrim)**

**Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:**

- Bashkëpunon ngushtë me ekspertin e GIS-it.
- Në bashkëpunim me ekspertin për matje është përgjegjës për të gjitha punët gjeodezike.
- Bënë kontrollin e kualitetit të dhënave gjeodezike dhe hidroteknike sipas manualeve skicave, dhe planeve ekzistuese.
- Kryen matjet gjeodezike në infrastrukturën e Ujësjellësit në tërë zonën e shërbimit, sipas kërkesave brenda kompanisë.
- Bënë kontrollin e kualitetit të shënimeve ekzistuese në formatin DĚG dhe përgatitë këto të dhëna për futjen e tyre në GIS- (Sistemin Gjeo-Informativ).
- Futë të gjitha të dhënat në aplikimin e GIS-it.
- Bënë planin vjetor për matjen-regjistrimin dhe azhurnimin e të dhënave në GIS lidhur me infrastrukturën e Ujësjellësit në tërë zonën e shërbimit.
- Këshillon dhe ndihmon departamentet e tjera të KRU "Prishtina" në zgjidhjen e çështjeve relevante inxhinierike që kanë të bëjnë me lëminë e GIS-it dhe gjeodezisë.
- Bënë azhurnimin e të dhënave gjeodezike dhe hidroteknike.
- Pranon punë dhe përgjegjësi të tjera nga udhëheqësi.
- I raporton Shefit të Shërbimit të Gjeodezisë dhe GIS-it.
- Të jetë komunikativ dhe i orientuar në punë grupore.
- Duhet të posedoj aftësi të shkëlqyera hartuese, analitike, komunikuese dhe nder njerëzore.
- Kryen punë tjera dhe i raporton Shefit të Shërbimit dhe Menaxherit të Departamentit.

### **Inxhinier të mjedisit, mbrojtje dhe siguri në punë**

**Përgatitja arsimore/profesionale: Diplomë Masteri Teknik, Fakulteti i Emergjencave**

**Përvoja e punës: minimum 2 vite**

**Numri i kryeseve: 2**

**Njohja e gjuhës Angleze: Mirë (në të folur dhe në shkrim)**

**Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:**

- Bënë vlerësimin e rrezikshmërisë së vendeve të punës në Departament, në vend punime të Projekteve të ndërmarrjes detyrat.
- Jep udhëzime adekuate për shmangien e rreziqeve të mundshme.
- Ofron rekomandime për metodat dhe mekanizmat për luftimin e rreziqeve të mundshme.
- Propozon adaptimin e kushteve të punës ndaj individëve/stafit, veçmas në lidhje me karakteristikat e vendit të punës dhe me ambientet e punës.
- Rekomandon metoda dhe procese të punës të cilat lehtësojnë dhe shmangin punën e njëtrajtshme/monotone me qëllim reduktimin e efekteve të punës monotone në shëndet.
- Zhvillon rregulla dhe procedura për mbrojtje të shëndetit dhe sigurisë në punë që ndërlidhen me teknologjinë e punës, organizimin e punës, kushtet, mjedisin dhe marrëdhëniet sociale në ndërmarrje.
- Ofron rekomandime për përshtatje me progresin teknologjik.
- Harton dhe zbaton procedurat në pajtim me ligjin për mbrojtje të shëndetit, të sigurisë dhe të një ambienti të favorshëm për punë.
- Mbi punën e kryer raporton në baza ditore, javore dhe mujore.
- Kryen edhe punët tjera të cilat delegohen nga Menaxhmenti.

**Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:**

- Aplikacioni;
- CV në gjuhën Shqipe dhe Angleze;
- Diploma e përgatitjes profesionale-shkollëre;
- Përvojën e punës, të dëshmuar me pasqyrë të Trust-it;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Certifikata e lindjes;
- Certifikata që nuk është i dënuar dhe nën hetime, jo me të vjetër se 6 (gjashtë) muaj.

**Procedura për aplikim:** Aplikacioni merret në zyrat e KRU “Prishtina” Sh.A., ose në web-faqën [www.kru-prishtina.com](http://www.kru-prishtina.com), të njëjtit i bashkëngjiten fotokopjet e dokumenteve personale dhe dokumentacioni tjetër i kërkuar sipas Konkursit dhe dërgohen në adresën KRU “Prishtina” Sh.A., në Prishtinë, Rr.”Hazir Shala“ nr.4, në zyrën nr.44, më së voni deri me **04.07.2023** në ora **16.00 h**.

**Vërejtje:** Kërkesat e kandidatëve me dokumente të pakompletuara do të refuzohen, ato që arrijnë pas afatit nuk do të merren në shqyrtim. Dokumentacioni i dorëzuar përmes Postës pranohet brenda afatit prej 72 orësh pas mbylljes së konkursit.

Dokumentacioni pranohet në kopje dhe nuk u kthehet kandidatëve.

